



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2020:187713

Datë: 28.02.2021

Numri i dokumentit: 01549076

P.nr.03/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtari **Sulltan Dobraj** e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, në lëndën penale kundër të pandehurit Sh. B. nga fshati K-....., i akuzuar sipas PTH-ës nga Peja me aktakuzën **PP/II.nr.2350/2020 te dt.29.12.2020** për veprën penale lajmërimi apo kallezim i rrem nga neni 382 par.1 të KPRK-ës, pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë me dt.11.02.2021 në praninë e prokurorit te shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi të pandehurit, me dt. 12.02.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. **28.02.2021** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Sh. B.**, i lindur me dt....., në fshatin K-....., ku dhe tani banon, i biri i Cenës dhe nënës Safete, me numër personal, me numër tel....., shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ESHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me datën 09.08.2020 rreth orës 23;55 minuta, në, pikërisht në Stacionin Policor, bën lajmërim të rrem të personit zyrtar i ngarkuar për të hetuar apo ndjekur, se personi i caktuar ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ,në atë menyrë që i pandehuri shkon në Stacionin Policor ku deklaron se F. H. e ka goditur me një mjet të fort (Brisk) në dorën e djathtë dhe në stomak ,e si pasojë e kësaj edhe i ka shkaktuar lëndime trupore, e pasi F. H. në Polici e mohon një gjë të tillë ,policia e fton sërish të pandehurin në stacion, ku i njëjti pranon se ka deklaruar rrejshëm se kinse është sulmuar nga F. dhe së plagët i ka shkaktuar vetë.

-Me çka ka kryer vepër penale lajmërimi apo kallëzimi i rrem nga neni 382 par.1 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 17, 81, 82 nenit 382 par.1 të KPK, nenit 498, 499 te KPPK-ës, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me këtë vërejtje gjyqësore të pandehurit i bëhet me dije se e ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbenë veprë penale dhe nëse kryen prapë një veprë të tillë, gjykata do të shqiptoj sanksion me të rëndë penal.

I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore nga Peja me Aktakuzën PP/II.nr.2350/2020 te dt.29.12.2020, ka akuzuar te pandehurin Sh. B. nga fshati K-....., për veprën penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 paragraf 1 të KPRK-ës, ka propozuar të administrohen të gjitha provat e duhura e më në fund i pandehuri të shpallet fajtorë dhe të dënohet në bazë të ligjit si dhe të detyrohet në pagesën e shpenzimeve procedurale-penale.

Gjykata me dt.11.02.2021 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestarë gjyqësor ku i pandehuri e ka pranuar fajësinë te cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim ne procesverbal te shqyrtimit të dytë në bazë të nenit 248 te KPPK.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike se i pandehur me datën 09.08.2020 rreth orës 23:55 minuta, në, pikërisht në Stacionin Policor, bën lajmërim të rrem të personit zyrtar i ngarkuar për të hetuar apo ndjekur, se personi i caktuar ka kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ,në atë mënyrë që i pandehuri shkon në Stacionin Policor ku deklaroi se F. H. e ka goditur me një mjet të fort (Brisk) në dorën e djathtë dhe në stomak ,e si pasojë e kësaj edhe i ka shkakuar lëndime trupore, e pasi F. H. në Polici e mohoi një gjë të tillë ,policia e fton sërish të pandehurin në stacion, ku i njëjti pranon se ka deklaruar rrejshëm se kinse është sulmuar nga F. dhe së plagët i ka shkakuar vetë.

Gjykata paraprakisht te pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do te shpallet fajtor për veprën penale te lartcekur, do ti shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do të këtë procedure te provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë i pandehuri i cila i ka pasur te njohura natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë, dhe ne mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet ne barre, i cili pranim fajësie mbështetet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht ne kuptim te nenit 257 te KPP-ës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë komfor nenit 248 te KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bere në mënyrë vullnetare, andaj kjo gjykate

ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale Lajmërimi apo Kallëzimi i rrem nga neni 382 paragraf 1 të KPRK-ës, ka konstatuar se i pandehuri është përgjegjës për këtë veprë penale, ka vendosur dhe të pandehurin e shpall fajtor për këtë veprë penale, i ka shqiptuar vërejtjen gjyqësore.

Me rastin shqiptimit të vërejtjes gjyqësore gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat mund të ndikojnë në shqiptimin e vërejtjes gjyqësore ndaj të pandehurit. Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje, i pa dënuar më parë, gjendja e rëndë ekonomike ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Gjykata ka vlerësuar se vërejtja e shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, dhe në këtë mënyrë do të ndikoj në arritjen e qëllimit të dënimit të paraparë me nenin 38 dhe 81 të KPK-së, si mase për rehabilitimin e të pandehurit por edhe si mase për parandalimin e të pandehurit dhe personave të tjerë kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata në bazë të nenit 453 të KPPK e ka liruar të pandehurin nga shpenzimet e procedurës penale sepse ka konsideruar se i pandehuri është i gjendjes së rëndë ekonomike dhe po që se ngarkohet edhe me shpenzime të procedurës penale do të rendohej edhe me shumë gjendja ekonomike e tij dhe e familjes së tij.

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,
P. nr.03/2021 te dt.28.02.2020**

Sekretarja juridike

Sabiha Hoxha

G J Y Q T A R I

Sulltan Dobraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet Gjykatës Themelore Pejë dega ne Deçan.